L I G J
Nr.8653, datë 31.7.2000

PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1 dhe 108 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ndarja administrativo-territoriale e njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë:

1. Qarqe……. 12
   - Nënndarja e qarqeve, rrethe 36, sipas pasqyrës, që i bashkëlidhet këtij ligji.
2. Komuna……309
3. Bashki……. …… 65
   - Bashkia e Tiranës ka 11 njësi bashkiake.

Neni 2

Shtrirja, emri dhe qendra e çdo njësie të qeverisjes vendore është sipas pasqyrës, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2723, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.